REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 282/20
Datë/Datum. 20.05.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	**12.05.2019**	**20.05.2020**	**Nr.282/20**
Emri dhe Mbiemri i ekspertit Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 07.05.2020, OE **"Ejona"**- Pejë, ka parashtruar ankesë me **nr.282/20**, kundër vendimit për **dhënie** të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve"** me nr. prok.70030-20-1109-2-3-6, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Spitali i Përgjithshëm Pejë.**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **9.000,00 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së,
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
- Neni 108/A i LPP-së Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- neni 41.8, 41.8, 41.10, 43.3 – RRUOPP

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/**nuk** janë te njëjta.
1) OE i shpallur fitues, ka gabime aritmetikore ne Para masën e dorëzuar te cilat çuditërisht AK nuk i ka vërejtur.
Tek pozicionet 29, 30 OE i shpallur fitues tek çmimi njësi ka vendosur çmimin për njësi me TVSH 59.00 euro, ndërsa tek Totali me TVSH ka vendosur çmimin 708.00. Ndërsa tek pozicioni 31 Çmimi për njësi me TVSH ka vendosur vlerën 23.60euro ndërsa tek totali 283.20 euro. Tek te këto tri pozicione njësia është Paushall (ku gjithmonë duhet te kalkulohet x1) e jo sic ka vepruar AK ku ka shumëzuar me 12.
Pra me përmirësimin e kalkulimit pas gabime aritmetike, diferenca ne çmim del 1,557.60 euro, ku edhe e kalon 2% te lejuar sipas "RREGULLAT dhe UDHEZUESI OPERATIV per PROKURTMIN PUBLIK".
Andaj, AK i shpallur fitues pas përmirësimit te gabimeve aritmetikore duhet shpallur i Eliminuar nga ky Aktivitet Publik pasi qe diferenca del te jete 35% nga Çmimi Total me TVSH I ofertës se OE Interservis,

2)AK ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 108/A pasi qe nuk ka respektuar afat ligjore per parashtrim te ankesës ne OSHP, dhe ka publikuar Njoftimin për Dhënie te Kontratës dhe ne sistemin e E-Prokurimit lash aktiviteti ne fjale figuron "ME KONTRATË".Pra jemi te sigurt se AK veç e ka nënshkruar kontratën me OE te shpallur fitues pa përfunduar afatet kohore per ankese pranë OSHP-se. Andaj, me këtë ankese shpresojmë se OSHP do te ndërmarrë masat e duhura per ndalimin e këtyre shkeljeve ligjore nga AK. Fillimisht duke shpallur te eliminuar OE te shpallur fitues dhe duke kthyer lenden ne Rivlerësim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

Autoriteti kontraktues nuk është eliminuar por është shpalle i pasuksesshëm.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, për të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni vlerësues konstaton se është rekomanduar për kontrate OE i cili ka ofruar çmimin me te ulet.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Ka pasur vendim te me hershem te OSHP-se. Nuk ka pasur

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Ejona"- Pejë

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i shpallur fitues, ka gabime aritmetikore ne para masën e dorëzuar te cilat çuditërisht AK nuk i ka vërejtur, tek pozicionet 29, 30 OE i shpallur fitues tek çmimi njësi ka vendosur çmimin për njësi me TVSH 59.00 euro, ndërsa tek Totali me TVSH ka vendosur çmimin 708.00. Ndërsa tek pozicioni 31 Çmimi për njësi me TVSH ka vendosur vlerën 23.60euro ndërsa tek totali 283.20 euro. Tek te këto tri pozicione njësia është Paushall (ku gjithmonë duhet te kalkulohet x1) e jo siç ka vepruar AK ku ka shumëzuar me 12, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në formën siç është krijuar tabela për përshkrimin e çmimeve ne dosjen e tenderit ka lënë mundësi të plotësimit të sajë në dy mënyra për pozicionet nr. 29, 30 dhe 31. Edhe në mënyrë siç është plotësuar nga OE ankues nuk paraqet gabime aritmetike në totalin e sajë.
Në tabelën e çmimeve të ofertës së OE fitues, nuk ka asnjë gabim aritmetikor në llogaritjen e çmimeve për asnjërin nga pozicionet në fjalë, siç e potencon OE ankues. Oferta e OE fitues pasqyron gjendjen e saktë financiare në totalin e sajë sipas llogaritjeve matematikore në të tri pozicionet.
Nuk ka asnjë gabim aritmetik në llogaritjen e ofertës së OE fitues për pozicionet 29, 30 dhe 31 sepse çmimi për njësi ne këto pozicione është dhënë me TVSH ndërsa te totali është llogaritur për 12 muaj, kërkesë kjo e dosjes se tenderit. E rëndësishme është që çmimi për njësi është i saktë në secilin pozicion dhe po ashtu edhe çmimi total për 12 muaj për të tri pozicionet është i saktë. Nuk ka tejkalim prej 2% te vlerës se ofertës financiare siç pretendohet. Prandaj për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është i **pa bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.2
Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me Nenin 108/A pasi qe nuk ka respektuar afatet ligjore për parashtrim te ankesës ne OSHP, dhe ka publikuar Njoftimin për Dhënie te Kontratës dhe ne sistemin e E-Prokurimit tash aktiviteti ne fjale figuron "ME KONTRATË", eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Autoriteti kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës ende pa kaluar afati për ankesa në OSHP nga operatorët ekonomik. Në këtë rast nga AK-ja nuk janë respektuar dispozitat e nenit 108/A për afatin e paraqitjes së ankesave. Megjithatë OE ankues ka bërë ankesë në OSHP dhe kjo ankesë është pranuar si e valide për trajtim. Po ashtu AK ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës i cili është i publikuar edhe në platformën elektronike të KRPP-së. Prej këtij veprimi të AK-së nuk është dëmtuar OE ankues. Si do që të jetë pretendimi ankimor është i **bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në përputhje me dispozitat e nenit 59 të LPP-së. Është rekomanduar për kontratë **oferta me çmimin më të ulët të peshuar** sipas kritereve të dhënies së kontratës. Oferta e OE fitues nuk ka gabime aritmetikore në kalkulimin e sajë për tri pozicionet e theksuara në ankesë. Vetë forma e dhënë e tabelës në dosje të tenderit për plotësimin e çmimeve ka dhënë mundësin e plotësimit në dy mënyra, por kjo nuk ka ndikuar në ndryshim të rezultatit as në çmimin për pozicion në njësi as në totalin e ofertës.

Si përfundim në shqyrtimin e kësaj lënde, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **Aprovohet pjesërisht** si e bazuar por kjo nuk do të ndikoj në ndryshimin e vendimit të AK-se për këtë aktivitet të prokurimit.
Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të **vazhdoj** me dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve"** me nr. prok.70030-20-1109-2-3-6 në përputhje me dispozitat e LPP-së

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:
- Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm Pejë
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Ejona"